

Pershendetje!

Lidhur me sa kerkohet ne shkresen bashkelidhur, ju bejme me dije se:

1. Ne zbatim te Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” , pranimet e studentëve në institucionet e arsimit të lartë, në të gjitha programet e studimit, për vitin akademik 2016 – 2017, u bënë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga vetë IAL-të dhe për kuotat e deklaruar prej tyre, të cilat u verifikuan nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), përpara fillimit të procesit të aplikimeve për pranimet në IAL-të, në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore.

Sa me siper, kuotat e deklaruar nga IAL-te, per cdo program studimi, te ndara sipas kategorive, jane te aksesueshme per publikun ne faqen zyrtare te MAS ne

linkun http://www.arsimi.gov.al/al/ar_simi/universiteti/pranimet-ne-universitetet-publike.

2. Ne zbatim te Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, cdo institucion i arsimit të lartë detyrohet të mbajë në formë të shkruar regjistrin themeltar të studentëve.

Sa me siper, informacioni lidhur me studentet e regjistruar administrohet nga vete IAL-te.

Flm